



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 221

Tiranë – E enjte, 17 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9844, datë 10.11.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 22881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 9.11.2016	Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimit të të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të MZSH- së..... 22881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 9.11.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve”..... 22881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016	Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike..... 22882
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 9.11.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve..... 22884
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 9.11.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 22885
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 9.11.2016	Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k..... 22885
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 9.11.2016	Për ndryshimin e statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane truall”, të pasurisë nr. 44/27, në zonën kadastrale 2636, Bashkia Fier, të pasurive nr. 64/25 dhe nr. 64/27, zona kadastrale 3743, Bashkia Patos, të pasurisë nr. 586/13, zona kadastrale 1724, Bashkia Lushnjë, dhe të pasurisë nr. 20/1, zona kadastrale 3195, Bashkia Berat..... 22888

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 9.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi dhe rikonstruksioni i bulevardit “Fan Noli””, në Bashkinë e Korçës.....	22889
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 9.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i Rrugës së Durrësit, në qytetin e Fushë-Krujës”, në Bashkinë e Krujës.....	22890
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 9.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Asfaltim i rrugëve dhe trotuarit pranë stadiumit “Qemal Stafa”, Tiranë”.....	22891
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 9.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës “Kosova””, Tiranë.....	22892
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 65, datë 7.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2015-2734, datë 14.5.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	22893
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 7.11.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	22896
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 67, datë 25.10.2016	Për miratimin e deklaratës për dhënien e ndihmës <i>De minimis</i>	22901
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 68, datë 25.10.2016	Autorizim i dhënies së ndihmës shtetërore “Për projektin të rejat drejt një profesioni”.....	22903
Udhëzim i përbashkët i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ALUIZNI-it nr. 4695/4, datë 2.11.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4695, datë 31.5.2016, “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar”.....	22905
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 174, datë 7.11.2016	Mbi miratimin e kontratës/marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016.....	22905
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 7.11.2016	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Tuc” dhe “Lumzi”.....	22910
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 7.11.2016	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	22910
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 8.11.2016	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve, të propozuara nga shoqëria “OSHEE” sh.a., në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 166, të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016.....	22911

Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shpëtim Dauti.....	22914
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhavit Salia.....	22914

**DEKRET****Nr. 9844, datë 10.11.2016****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, nenit 11 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Driton Kadri Qehaja
2. Klesta Driton Qehaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM**Nr. 784, datë 9.11.2016**

**PËR MËNYRËN DHE KRITERET E
LLOGARITJES SË SHPENZIMEVE TË
NDËRHYRJES PËR SHUARJEN E
ZJARREVE NË OBJEKTET E
SIGURUARA NGA ZJARRI DHE
ADMINISTRIMIN E PËRDORIMIN E TË
ARDHURAVE, PËR LLOGARI TË
SHËRBIMIT VENDOR TË MZSH-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 35, ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH-së në objektet e siguruar nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit është në vlerën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për orë ndërhyrjeje.

2. Për efekt të përllogaritjes së kostove të shërbimit, të ofruar nga shërbimi i MZSH-së në nivel vendor, koha e ndërhyrjes llogaritet nga

momenti i daljes së personelit të shërbimit të MZSH-së nga stacioni zjarrfikës dhe përfundon me largimin e tij nga vendi i ngjarjes.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin informon zyrtarisht kryetarët e bashkive për listën e objekteve të siguruar në territorin nën juridiksionin e tyre.

4. Shumat e arkëtuara nga shoqëritë e sigurimit, që kërkojnë ndërhyrje për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar, derdhen në llogaritë e bashkisë përkatëse që ka ofruar shërbimin.

5. Të ardhurat, që krijohen sipas pikës 4, të këtij vendimi, administrohen nga bashkia përkatëse që ka ofruar shërbimin e MZSH-së dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera, financimin e veprimtarive kryesore, shpenzime operative, rinovim të automjeteve e të pajisjeve zjarrfikëse, për investime dhe shpërblimin e punonjësve të shërbimit vendor të MZSH-së.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkitë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

VENDIM**Nr. 785, datë 9.11.2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 1299, DATË
16.12.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË
NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE
NË BASHKI/NJËSI BASHKIAKE/
KOMUNA DHE NË DEGËT E
QARQEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pasqyrën nr. 2, të vendimit nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



a) Në tabelën e organikës së shërbimit të gjendjes civile për qarkun Durrës, Bashkia Durrës, pas nënndarjes me numër 6, shtohet nënndarja 6/1, me këto të dhëna:

“6/1. Durrës; Durrës, Rajoni 6; 1.”.

b) Në tabelën e organikës së shërbimit të gjendjes civile për qarkun Korçë, Bashkia Kolonjë, hiqet Njësia Administrative Barmash nga rreshti me numër rendor 3 dhe shtohet në rreshtin me numër rendor 2, në të njëjtën rubrikë.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 786, datë 9.11.2016

PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE, SI DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 9, e 60, pika 1, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e kriterëve e të procedurave transparente të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit të anëtarëve të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike (në vijim bordi), si dhe të rregullave të funksionimit të bordit për të siguruar funksionimin e duhur të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim synon garantimin e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të lartë moral të anëtarit të bordit.

II. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT

1. Bordi është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë jopraktikues, të emëruar nga ministri i Financave, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, jo më shumë se dy herë.

2. Kryetari dhe tre anëtarët e bordit, që propozohen nga ministri i Financave, duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar (këtu e në vijim “ligji”).

3. Kandidati që përzgjidhet nga institucionet publike të arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të ligjit, dhe të jetë pjesë e stafit të përhershëm të institucionit publik të arsimit të lartë.

4. Anëtari i pestë i bordit, i propozuar nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të ligjit.

5. Njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të ligjit, dhe vendi e afati i dorëzimit të dokumentacionit caktohen me urdhër të ministrit të Financave.

6. Njoftimi i konkurrimit për anëtar të bordit përmban këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që do të mbulojë anëtari;

b) kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

ç) mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit, sipas pikës 2, të këtij kreu, kryhet nga një komision *ad-hoc* i ngritur me urdhër të ministrit të Financave, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.



8. Kandidatët, që aplikojnë për anëtarë të bordit, dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim;
- b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);
- c) Curriculum vitae;
- ç) dy vlerësimet e fundit vjetore, në rast se kandidati vjen nga institucionet publike;
- d) kopje të noterizuar të librezës së punës;
- dh) kopje të noterizuar të diplomës;
- e) vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit sipas përcaktimeve të pikës 4/d të këtij kreu;
- ë) kopje të noterizuara të dëshmive e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;
- f) dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “ë”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit.

10. Komisioni *ad-hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pikës 4, të nenit 4, të ligjit, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, i cili i paraqitet për miratim ministrit të Financave.

Në relacion, komisioni i rekomandon ministrit të Financave emërimin e kandidaturave.

11. Në rastin e anëtarit të bordit që përzgjidhet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Ministria e Financave paraqet pranë Kuvendit të Shqipërisë kërkesën për paraqitjen e kandidaturës përkatëse.

III. LIRIMI DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË BORDIT

1. Anëtar i bordit lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) mbaron mandati;
- b) jep dorëheqjen;
- c) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson, në rastet kur anëtar i bordit vjen nga institucionet publike.

2. Ministri i Financave ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të bordit:

- a) kur nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e bordit për më shumë se katër herë radhazi;

b) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmton rëndë veprimtarinë dhe emrin e bordit;

c) kur nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe ky vendim;

ç) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;

dh) për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

e) nëse, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron në kundërshtim me interesat e bordit.

3. Ministri i Financave, në rastet kur anëtar i bordit lirohet, shkarkohet, dorëhiqet apo vdes, duhet të caktojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e njoftimit të lirimit, shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes, të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi. Në rastin e anëtarëve të emëruar me propozim të Komisionit Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, propozimi për anëtarin zëvendësues bëhet nga ky institucion.

4. Mandati i zëvendësuesit llogaritet i plotë nga dita e emërimit të tij.

5. Kryetari i bordit, 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të mandatit, për rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 1, të këtij kreu, njofton, me shkrim, ministrit të Financave për përfundimin e mandatit të anëtarit/anëtarëve.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të rinj realizohet sipas dispozitave dhe afateve të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

IV. RREGULLAT E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË BORDIT

1. Bordi e zhvillon veprimtarinë në bazë të një programi vjetor pune, i cili i paraqitet për njohje ministrit të Financave, së bashku me raportin për veprimtarinë njëvjeçare, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit të bordit.

2. Mbledhjet e bordit zhvillohen në vendin e përcaktuar në shkresën e thirrjes. Bordi, si rregull, zhvillon një mbledhje në muaj, por mund të mbledhet sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.

3. Thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i bordit, i cili vendos datën, rendin e ditës dhe orën. Në mungesë të tij, me miratim dhe porosi të



kryetarit, mbledhja thirret nga anëtari më i vjetër në detyrë dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.

4. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e bordit, kur kjo kërkohet me shkrim nga, të paktën, 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjes, në këtë rast, bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve dhe, të paktën, brenda 5 (pesë) ditëve pune para datës së caktuar për mbledhje.

Lajmërimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë qartë dhe me hollësi çështjet, që do të diskutohen dhe dokumentacionin përkatës. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtari të bordit jo më vonë se 2 (dy) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes.

5. Mbledhja e bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Në rastin kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e saj në një ditë tjetër, të paktën, 24 (njëzet e katër) orë pas së parës.

6. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

7. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vendimet kundër duhet të shpjegohen.

8. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, me shkrim, i cili përmban një përmbledhje të të gjithë procesit, por pa u kufizuar në opinione të anëtarëve, të dhëna për datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimin, vendimet që u morën, si dhe rezultatit e votimeve. Procesverbali mbahet nga struktura mbështetëse e bordit dhe duhet të paraqitet për nënshkrim të të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.

9. Bordi mund të përcaktojë rregulla të hollësishme për procedurat specifike të punës për raste e çështje të caktuara.

10. Bordi i dërgon ministrit të Financave një herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, një raport me shkrim, ku jepen me

hollësi problemet e profesionit të audituesit ligjor, zgjidhjet e dhëna dhe vendimet e marra.

11. Anëtarët e bordit, gjatë ushtrimit të detyrës, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionin që sigurohet prej tyre dhe të mos i përdorin ato për interesa personale.

12. Kryetari dhe anëtarët e bordit shpërblehen në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

13. Për aq sa nuk parashikohet në këtë vendim, procedura e zhvillimit të mbledhjeve të bordit rregullohet nga parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Financave, që, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të emërojë anëtarët e bordit, sipas propozimeve të bëra nga autoritetet e parashikuara në këtë vendim.

2. Bordi thërret mbledhjen e parë, brenda 1 (një) muaji nga konstituimi i tij.

3. Vendimi nr. 874, datë 12.8.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike të Ekspertëve Kontabël, të Regjistruar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 787, datë 9.11.2016

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në zërin “Shpenzime korrente”, të shtohet fondi prej 4 907 000 (katër milionë e nëntëqind e shtatë mijë) lekësh, me qëllim organizmin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kolonjë.

2. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 788, datë 9.11.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHE PËR VITIN 2016 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “...2210 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, në ndarjen “Gr.14, Ministria e Drejtësisë”, shtohet nënndarja sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Periudhë kohore
14	Ministria e Drejtësisë	3			
	Arkivi Shtetëror Gjyqësor	3	Operator	8 orë/ditë	4 muaj

VENDIM

Nr. 792, datë 9.11.2016

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E
IMPIANTIT ME RIKUPERIM TË
ENERGJISË NGA TRAJTIMI I MBETJEVE
URBANE, NË QYTETIN E ELBASANIT,
SHOQËRISË “ALBTEK ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

MIRATIM

Nr. 4554/ datë 31.10 2016
7

PËR

**NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E IMPIANTIT ME
RIKUPERIM TË ENERGJISË NGA TRAJTIMI I MBETJEVE
URBANE, NË QYTETIN E ELBASANIT, NGA SHOQËRIA
“ALBTEK ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 49, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të Vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”,

Duke pasur parasysh se:

- a) Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me Nr.L41914013H, me seli në Tiranë, në adresën Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Zyra 13/2, është pajisur me autorizim paraprak Nr.6970/5 datë 18.2.2015;
- b) Shoqëria ka paraqitur studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social me të dhënat e zonës së zbatimit të projektit;
- c) Shoqëria mbështetur në këtë studim, ka nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit një kontratë koncesioni të formës BOT, për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane në Qarkun e Elbasanit;
- d) Shoqëria ka paraqitur planin e biznesit dhe grafikun e zbatimit të projektit;
- e) Shoqëria ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejta mbi sipërfaqen e truallit ku do të ndërtohet impianti;
- f) OSHEE ka dhënë miratimin paraprak për lidhjen e këtij impianti me rrjetin e shpërndarjes;

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) autorizon shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, me kushtet dhe specifikat si vijon:



1. Impianti do të ndërtohet brenda sipërfaqes së përcaktuar me vendimin Nr.117 datë 19.12.2014, të Këshillit Bashkiak të Elbasanit.
2. Impianti që miratohet të ndërtohet ka karakteristikat e mëposhtme:
 - burimin gjenerues të energjisë elektrike prej djegies të mbetjeve të ngurta urbane (MNU);
 - kapaciteti i instaluar është 2,9 MW;
 - konsumi i brendshëm i centralit 0,35 MW;
 - kapaciteti neto prodhues është 2,55 MW;
 - prodhimin vjetor i energjisë elektrike 17,250 MWh;
 - jetëgjatësia e pritshme e burimit gjenerues të energjisë është 313 ditë pune në vit;
 - tensioni nominal në dalje të gjeneratorit është 400 V;
 - impianti do të lidhet në Nst 400/220/30 kV, në zbarrat 30 kV;
3. Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., do të përfundojë ndërtimin e impiantit brenda 18 muajve nga fillimi i punimeve të ndërtimit.
4. Shoqëria do të raportojë çdo muaj pranë MEI-t mbi ecurinë e ndërtimit dhe operimit të këtij impianti. MEI ka të drejtë të kërkojë çdo informacion tjetër shtesë që e konsideron të nevojshëm në zbatim të kushteve të këtij autorizimi.
5. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij miratimi, do të nënshkruhet një kontratë ndërmjet MEI-t dhe Shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k mbi afatet dhe penalitetet në rast mosrealizimi në kohë të projektit apo transferimit të autorizimit pa miratim, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e projektit.
6. Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., do t’i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë, një royalty të barabartë me 2% të sasisë vjetore të energjisë së prodhuar ose vlerën në lekë të kësaj sasive së bashku me çdo përfitim tjetër shtesë, të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë.
7. Kohëzgjatja e këtij miratimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi.
8. Miratimi hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për dhënien e këtij miratimi.

MINISTRI
Damian Gjijnuri

**VENDIM****Nr. 794, datë 9.11.2016**

PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE TRUALL”, TË PASURISË NR. 44/27, NË ZONËN KADASTRALE 2636, BASHKIA FIER, TË PASURIVE NR. 64/25 DHE NR. 64/27, ZONA KADASTRALE 3743, BASHKIA PATOS, TË PASURISË NR. 586/13, ZONA KADASTRALE 1724, BASHKIA LUSHNJË, DHE TË PASURISË NR. 20/1, ZONA KADASTRALE 3195, BASHKIA BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane truall”, të pasurisë nr. 44/27, në zonën kadastrale 2636, njësia administrative Mbrostar, Bashkia Fier, të pasurive nr. 64/25 dhe nr. 64/27, zona kadastrale 3743, njësia administrative Zharrës, Bashkia Patos, të pasurisë nr. 586/13, zona

kadastrale 1724, njësia administrative Krutje, Bashkia Lushnjë, dhe të pasurisë nr. 20/1, zona kadastrale 3195, njësia administrative Roshnik, Bashkia Berat, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës përkatësisht në qarqet e Fierit e të Beratit të pasqyrojnë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e kategorisë së resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane truall”, të pasurisë nr. 44/27, zona kadastrale 2636, njësia administrative Mbrostar, Bashkia Fier, të pasurive nr. 64/25 dhe nr. 64/27, zona kadastrale 3743, njësia administrative Zharrës, Bashkia Patos, të pasurisë nr. 586/13, zona kadastrale 1724, njësia administrative Krutje, Bashkia Lushnjë, dhe të pasurisë nr. 20/1, zona kadastrale 3195, njësia administrative Roshnik, Bashkia Berat.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Fier, Këshilli i Qarkut Berat dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, Lushnjë e Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. në m ²	Vendndodhja	Bashkia	Lëshuar certifikata
1	44/27	2636	5000	Mbrostar	Fier	ZVRPP Fier
2.	64/25	3743	2400	Verbas	Patos	ZVRPP Fier
3	64/27	3743	4500	Verbas	Patos	ZVRPP Fier
4	586/13	1724	2000	Gjaze	Lushnjë	ZVRPP Lushnjë Certifikatë për dhënie me qira
5	20/1	3195	2100	Roshnik	Berat	ZVRPP Berat

**VENDIM****Nr. 795, datë 9.11.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI
DHE RIKONSTRUKSIONI I
BULEVARDIT “FAN NOLI”, NË
BASHKINË E KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi dhe rikonstruksioni i bulevardit “Fan Noli”, në Bashkinë e Korçës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën

bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë truall”, me sipërfaqe 82,24 (tetëdhjetë e dy presje njëzet e katër) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet buxheti i Bashkisë Korçë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Korçë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Korçës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë “tokë truall”, prej 82,24 (tetëdhjetë e dy presje njëzet e katër) m², për projektin “Zgjerimi dhe rikonstruksioni i bulevardit “Fan Noli”, të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**

**LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT
“ZGJERIM DHE RIKONSTRUKSIONI I BULEVARDIT “FAN NOLI”, NË BASHKINË E KORÇËS**

Nr. rendor	Emër atësi mbiemër	ZK	Nr. pasurie	Lloji i pas.	Truall (m ²) ZVRPP	Sip. e cila shpronësohet	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale e shpronësimit	Vërtetim nga ZRPPP-ja
1	Riza Kollel Kalemi Pranvera Veliu Aferdita Veliu Gazmend Veliu	8564	1/39	T+ND	534.0 m ² – 179.8 m ²	82.24	8537	702 083	Konfirmim nga ZRPPP-ja
	Totali							702 083	

**VENDIM****Nr. 796, datë 9.11.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË
DURRËSIT, NË QYTETIN E FUSHË-
KRUIJËS”, NË BASHKINË
E KRUIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i Rrugës së Durrësit, në qytetin e Fushë-Krujës”, në Bashkinë e Krujës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” me sipërfaqe 117,02 (njëqind e

shtatëmbëdhjetë presje zero dy) m², dhe “objekt” me një sipërfaqe 40,7 (dyzet presje shtatë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 3 346 779 (tre milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 346 779 (tre milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Krujë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Krujës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive “tokë truall” me sipërfaqe 117,02 (njëqind e shtatëmbëdhjetë presje zero dy) m², dhe “objekt” me sipërfaqe 40,7 (dyzet presje shtatë) m², për realizimin e projektit “Rikonstruksioni i Rrugës së Durrësit, në qytetin e Fushë-Krujës”, të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR
“RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SË DURRËSIT, NË QYTETIN E FUSHË-KRUIJËS”, BASHKIA KRUIJË**

Nr.	Emri mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja m ² truallit që do të shpronësohet	Sipërfaqe objektit m ²	Truall/çmimi në lek/m ²	Objekt/çmimi në lek/m ²	Vlera e përgjithshme në lek	Shënime
1	Ismet Eqrem Loci	1664	5/4	2.62		2795		7323	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Lulzim Eqrem Loci	1664	5/5	2.34		2795		6540	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Besnik Eqrem Loci	1664	5/3	3.36		2795		9391	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sabah Ahmet Stafuka	1664	6/163	4.02		2795		11236	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Sabah Ahmet Stafuka	1664	6/168	31.59		2795		88294	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Gani Bajram Selaci	1664	5/9	14.17		2795		39605	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Xhelal Hasan Riza	1664	5/10	11.58	11.58	2795	76500	1672082	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
			5/198+1-2	7.14	2.25	2795	51000		
			5/199+1-2		1.43	2795	51000		
					7.14		76500		



7	K.I.Doku shpk(Hyqmet Doku)	1664	6/18	17.48		2795		48856	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Arif Nazmi Disha Elsa Xhelal Disha	1664	N4/268+ 1-4		4.66		7 6500	356490	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Bashkëpronësi e familjes Çela	1664	6/161	15.58		2795		43546	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Xhumali Ali Cani	1664	N4/244		6.5		76 500	497250	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Risel Avni Lezaj	1664	5/252	7.14	7.14	2795	76 500	566166	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Totali				117.02	40.7			3 346 779	

VENDIM**Nr. 797, datë 9.11.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “ASFALTIM I
RRUGËVE DHE TROTUARIT PRANË
STADIUMIT “QEMAL STAFI”, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Asfaltim i rrugëve dhe trotuarit pranë stadiumit “Qemal Stafi”, Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “trual” dhe “ndërtësë”, me një vlerë të përgjithshme prej 183 626 878 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 183 626 878 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e

shtatëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**



LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “ASFALTIMI I RRUGËVE DHE TROTUARIT PRANË STADIUMIT “Q. STAFI”, TË MIRATUAR NË KËSHILLIN TEKNIK TË BASHKISË TIRANË ME VENDIMIN NR. 8/7, DATË 2.6.2016

Nr.	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	Zona kadastr	Nr. i pasurisë	SIP. përgj. tr. (m ²)	SIP. tr. prekur (m ²)	Çmimi i truallit lek/m ²	SIP. Obj. prekur (m ²)	Çmimi Obj. lek/m ²	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP-së, Tiranë
1	22 bashkpr.		Groni, Matoshi, Dervishi, Rama, Karaj, Shabaj, Kotoni, Boçi, Nikolla, Global Constr.	8160	6/380	6979.0	1710.00	66969			114,516,990	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
2	Azem		Neza	8160	6/132	116.0	116.00	66969	348.00	29245	17,945,572	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
9	9 bashkpr.		Tartari, Hoxha, Nepravishta	8160	6/370	1251.6	559.00	66969			37,435,671	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
11	12 bashkpr.		Groni, Dervishi,	8160	6/388	567.0	205.00	66969			13,728,645	Shkr.nr. prot.21101/2, datë 13.7.16
						SHUMA	2590,00		348,00		183.626.878	

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve mesatare të zërave të punës për qytetin e Tiranës, të vëna në dispozicion me shkresën nr. prot. 647/2, datë 15.3.2016 nga EKB-ja.

VENDIM

Nr. 798, datë 9.11.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SHKOLLËS “KOSOVA””, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës “Kosova””, Tiranë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme 165 312 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 165 312 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me



Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I SHKOLLËS “KOSOVA”“

Nr.	EMËR	MBIEMËR	Zona kadast.	Nr. i pasurisë	SIP. tr. të prekur (m ²)	Çmimi i truallit lekë/m ²	SIP. Obj. të prekur (m ²)	Çmimi Obj. lekë/m ²	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP- së, Tiranë
1	Bashkpron.	Grabocka, Kapo, Zere.	8160	2/76	2468,5	66,969	145	0	165.312.977	Shkr.nr. prot.9049/1, datë 18.4.16 Shkr. nr. prot.9049/3, datë 6.6.16
Shuma									165.312.977	lekë

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB-së, për vitin e ndërtimit dhe amortizimin.

VENDIM

Nr. 65, datë 7.11.2016

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 26.9.2016,
mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë
dokumentesh, çështjen me nr. 50 Akti, që u përket
palëve:

KËRKUESE: Aferdita Zoga

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e
Mbrojtjes

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me
Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-2734, datë
14.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së
Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe
134/1/g të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të
Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577,
datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së
Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari,
mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të
kërkueses, që është shprehur për pranimin e
kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të
interesuar, Ministria e Mbrojtjes, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja, me urdhrin nr. 1475, datë 5.8.2010
të ministrit të Mbrojtjes, është nxjerrë në rezervë
për shkak të ndryshimeve strukturore në Forcat e
Armatosura. Pasi ka ezauruar ankimin
administrativ, kërkuesja i është drejtuar me padi
gjykatës. Ajo ka kërkuar anulimin e urdhrin



administrativ dhe rikthimin në detyrën e mëparshme ose detyrë të njëjtë, si dhe pagimin e pagës së munguar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6558, datë 1.7.2011, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, anulimin e urdhrit nr. 1475/2010, rikthimin e saj në detyrën mëparshme ose një detyrë të njëjtë, si dhe pagimin e pagës nga data 1.7.2010 deri në ekzekutimin e vendimit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1301, datë 25.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2734, datë 14.5.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1301, datë 25.5.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 6558, datë 1.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

5. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se nuk është njoftuar për rekursin e paraqitur nga Ministria e Mbrotjes dhe për pasojë i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë. Sipas saj, vendimi i Gjykatës së Lartë është i pambështetur në ligj dhe në prova dhe bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe material. Ky vendim është në kundërshtim flagrant me detyrimet e kontratës së punës të lidhur midis palëve.

6. **Subjekti i interesuar** ka parashtruar se procesi i zhvilluar para kolegjit administrativ të gjykatës së lartë është bërë në përputhje me rregullat procedurale të parashikuara për këtë qëllim. Shqyrtimi i çështjes mund të bëhet edhe në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Data dhe ora e zhvillimit të seancës është shpallur nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të gjykatës së lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

7. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në

kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuksi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vëren se kërkuksja legjitimohet *ratione personae*, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/g të Kushtetutës. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata çmon se ajo legjitimohet për takon pretendimin për mosnjoftim të zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Kërkuksja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar që ka parashikuar neni 30/2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

B. Për pretendimin se nuk është njoftuar për zhvillimin e seancës gjyqësore

9. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare. Ajo u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse palët ndërgjyqëse nuk njoftohen për datën dhe orën e seancës, ato detyrimisht do të gjenden në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që u garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Sipas nenit 59, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, “pala, kundër së cilës është bërë rekurs, mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit”. Për sa i përket



shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

11. Gjykata e Lartë, në kuadër të garantimit të procesit të rregullt gjyqësor, ka detyrë të marrë masat për njoftimin e rregullt të subjekteve që potencialisht mund të preken nga procesi, në mënyrë që debati gjyqësor të zhvillohet në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Njoftimi i rekursit dhe i datës e orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi më tepër në rastin konkret ku Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkuësës. I takon Gjykatës së Lartë të verifikojë komunikimin e rekursit palës tjetër, në mënyrë që kjo e fundit jo vetëm të njihet në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesë argumentet e saj për çështjen.

12. Referuar dosjes gjyqësore rezulton se vendimi për shqyrtimin e rekursit është marrë në datën 22.4.2015. Sipas këtij vendimi, data për shqyrtimin e rekursit është vendosur më 14.5.2015. Njëkohësisht është urdhëruar edhe njoftimi i palëve. Referuar dosjes gjyqësore, në datën 13.11.2012 është bërë njoftimi i rekursit avokatit të kërkuësës N. Vata, i cili ka firmosur konform ligjit marrjen e rekursit. Ndërsa për sa i takon datës së zhvillimit të gjykimit të rekursit nuk rezulton që njoftimi të jetë bërë në përputhje me rregullat procedurale. Nga komunikimi telefonik me sekretarinë e Gjykatës së Lartë rezulton se njoftimi për shqyrtimin e çështjeve në dhomë këshillimi bëhet nëpërmjet faqes së internetit të Gjykatës së Lartë.

13. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se praktika e ndjekur nga Gjykata e Lartë për njoftimin e palëve nëpërmjet publikimit në faqen elektronike të asaj gjykate, nuk është në

përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit administrativ. Administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për njoftimin efektiv të kërkuësës, në mënyrë që debati gjyqësor të zhvillohej në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Njoftimi i palëve duhet të bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Është e vërtetë se mbrojtësi të cilit i është bërë njoftimi ka kryer përfaqësimin e kërkuësës në apel dhe ka firmosur për marrjen dijeni të rekursit, por Gjykata e Lartë duhej të verifikonte nëse ai ishte ende përfaqësues i kërkuësës, nëse kishte ende tagra për përfaqësimin e saj edhe në atë gjykatë apo nëse kishte hequr dorë nga përfaqësimi, me qëllim që të realizonte efektivisht të drejtën e mbrojtjes së kërkuësës në gjykimin para asaj gjykate. Si rrjedhojë, kërkuësja, për shkak se nuk iu komunikua data dhe ora e zhvillimit të seancës gjyqësore, për më tepër që nga gjykimi në Gjykatën e Lartë u prishën vendimet gjyqësore të mëparshme në favor të kërkuësës, ishte në pamundësi faktike për të paraqitur pretendimet e saj, duke sjellë për pasojë edhe humbjen e së drejtës për të paraqitur **pretendimet në një fazë të mëvonshme** në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit nr. 49/2012.

14. Gjykata vlerëson se ligji u garanton të drejtën palëve që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Moskomunikimi i zhvillimit të seancës kërkuësës nga ana e administratës gjyqësore, ka bërë që ajo të mos përfitojë nga këto garanci ligjore, çka e ka vënë në një pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër. Me këtë rast Gjykata thekson dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012 për gjykimin e çështjeve administrative. Megjithatë në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi



përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

15. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 29, datë 19.5.2016; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi kërkuases nuk i është dhënë mundësia të paraqesë argumentet e saj dhe të mbrohet kundër pretendimeve të palës kundërshtare.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2015-2734, datë 14.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 66, datë 7.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 26.9.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 51 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Esmal Malushi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Diana Cashku, Juliana Cashku etj.

Zyra e Përmbartimit Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Zyra e Përmbartimit Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kërkuesja është trashëgimtare ligjore e të ndjerit Gani Malushi. Ky i fundit në vitin 1995 ka lidhur një kontratë huaje me të paditurin (i vdekur në 1999) në shumën 1.300.000 lekë.

2. Pas përpilimit të kontratës dhe hyrjes në fuqi të saj, nga ana e të paditurit nuk janë respektuar kushtet e kontratës dhe për këtë qëllim i ndjeri Gani Malushi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke qenë se huamarrësi vdiq, të paditur u thirrën trashëgimlënësit e tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 338, datë 14.2.2000, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e palëve të paditura të zgjidhin kontratën e huas, kthimin e shumës 1.300.000 lekë Gani Malushit, si dhe interesat përkatëse të llogaritura.”* Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 28.2.2000.

4. Me kërkesë të paditësit është lëshuar urdhri ekzekutiv nr. 270, datë 24.5.2000 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe menjëherë pas kësaj kreditori i është drejtuar zyrës së përmbarimit Tiranë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

5. Ndërkohë, një nga debitorët (Diana Cashku) ka lidhur një kontratë dhurimi me shtetasin Agim Hasani, me anë të së cilës dhuruesja i ka kaluar 35% të aksioneve të shoqërisë AGITB shtetasit A.H. Kreditori nisur nga dyshimi se kontrata e dhurimit ishte fiktive dhe kishte si qëllim shmangien nga detyrimi të debitorit i drejtohet me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar pavlefshmëri absolute të veprimit juridik të dhurimit dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1324, datë 13.4.2001, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë.”*

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1060, datë 2.10.2001, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 1324, datë 13.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesëpadisë. Konstatimin e pavlefshëm të kontratës së dhurimit nr. 398, datë 5.10.1999 lidhur midis palëve Diana Cashku e Agim Hasani. Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.”*

8. Me vendimin nr. 907, datë 16.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar urdhri ekzekutiv për vendimin civil nr.

1060, datë 2.10.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Menjëherë pas këtij vendimi kreditori i është drejtuar sërish zyrës së përmbarimit për ekzekutimin edhe të këtij vendimi gjyqësor.

10. Nga periudha 2001 deri në vitin 2009 (kërkesa e datës 12.8.2009) kërkuesja (trashëgimlënësja e kreditorit) i është drejtuar vazhdimisht zyrës së përmbarimit për ekzekutimin e dy vendimeve të mësipërme.

11. Nga zyra e përmbarimit janë kryer fillimisht veprimet konkrete për ekzekutim, konkretisht kërkesa për vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e luajtshme të përbërë nga 35% e kapitalit Agitb, si dhe të ardhurat që sigurohen nga ky kapital. Po kështu në datën 30.11.2001 përmbaruesi i është drejtuar Zyrës së Regjistrat Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar fshirjen e shënimit të dhurimit të bërë për pjesën prej 35% të kapitalit nga ana e debitorës. Kjo kërkesë është përsëritur disa herë, konkretisht në vitet 2001, 2003 dhe 2004.

12. Pas kësaj periudhe ka pasur një heshtje dhe mosveprim nga ana e zyrës së përmbarimit, e cila në rrugë verbale i është përgjigjur interesimit dhe kërkesave të kërkueses (shih kërkesat e datave 2.6.2006, 12.8.2009 etj.) se *“dosja nu gjendet”*. Kërkuesja i ka riparaqitur dokumentet dhe procesi është riaktivizuar sërish në datën 18.10.2015 dhe, si pasojë, është nxjerrë akti për ekzekutim vullnetar, si dhe aktet drejtuar bankave të nivelit të dytë për sekuestro të llogarive të debitorëve. Kjo e fundit nuk është kryer pasi sipas bankës Raiffeisen dokumentacioni nuk plotëson kriteret ligjore.

13. Ndërkohë kërkuesja i është drejtuar edhe instancave administrative përkatëse për të vënë në lëvizje zyrën e përmbarimit, e cila megjithëse rifilloi procesin e ekzekutimit të të dyja vendimeve gjyqësore, nuk arriti ta realizojë detyrimin për ekzekutim. Kështu, ajo i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, e cila nga ana e saj pasi ka marrë informacion për ecurinë e procesit në zyrën e përmbarimit Tiranë, nuk ka dhënë ndonjë zgjidhje për situatën e krijuar nga zvarritja e procesit të ekzekutimit.

14. Gjithashtu, nisur nga përgjigja e zyrës së përmbarimit të datës 31.5.2016, rezulton se ajo zyrë i ka kryer të gjitha veprimet por nuk ka pasur sukses. Në datën 25.2.2016 zyra e



përmbarimit ka rifilluar veprimet përmbarimore duke kërkuar ekzekutimin vetëm për njërin vendim gjyqësor (konkretisht për vendimin nr. 338/2000). Me shkresën nr. 6741 prot. datë 18.7.2016, ka dalë urdhri për bashkimin e dosjeve për të dyja vendimet gjyqësore.

II

15. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi edhe pse nga momenti i fillimit të procedurave ka kaluar një periudhë tejet e gjatë, ende nuk është ekzekutuar detyrimi i përcaktuar nga ky vendim.

16. **Subjekti i interesuar, Zyra e Përmbarimit Tiranë** ka parashtruar se ka rifilluar veprimet përmbarimore duke kërkuar ekzekutimin vetëm për njërin vendim gjyqësor dhe duke bashkuar të dyja dosjet në një të vetme.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

17. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuësit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuësi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vlerëson se kërkuësja ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret ajo u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së saj. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkuësja i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm.

19. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuësja legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ajo ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

20. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

22. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa



nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

i) Kompleksiteti i çështjes

25. Për vlerësimin e kompleksitetit duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shpresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për pagimin e shumës së marrë hua në bazë të kontratës së huasë të lidhur me vullnet të lirë mes palëve. Kjo çështje në vlerësimin e Gjykatës nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuarës, palës debitoare dhe zyrës së përmbarimit është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Interesi dhe sjellja e kërkuarës

27. Në çështjen konkrete, sjellja e kërkuarës përcaktohet nga qëndrimi i saj gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Gjykata vlerëson se nuk është kërkuarja që është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo ka ndjekur rigorozisht të gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e saj të fituar

gjyqësisht, pra për të marrë shumën që i detyrohet debitori. Madje ajo ka nisur edhe një proces gjyqësor për të konstatuar veprimin juridik të dhurimit si të pavlefshëm, i cili ishte bërë me qëllim shmangien e debitorit nga pagimi i detyrimit ndaj kërkuarës. Në këtë mënyrë, sjellja e kërkuarës nuk mund të jetë shkak i vonesës së mosekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në rastin konkret interesi i kërkuarës është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e saj për t'iu kthyer shuma e huas. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuarja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ajo ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

28. Kështu, nga viti 2001 deri në vitin 2009 (kërkesa e datës 12.8.2009) kërkuarja i është drejtuar vazhdimisht zyrës së përmbarimit për ekzekutimin e të dyja vendimeve të mësipërme dhe nuk pasur asnjë reagim në drejtim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

iii) Sjellja e autoriteteve

29. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të*



Gjykatës Kushtetuese).

31. Në lidhje me autoritetin publik të përfshirë në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e tij. Gjykata konstaton se nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Tiranë nuk është bërë përpjekje serioze për të realizuar detyrën e saj funksionale, duke përfshirë mosekzekutimin prej vitesh të vendimeve gjyqësore. Kjo zyrë ka nxjerrë pengesa të vazhdueshme në formën e mosveprimit, humbjes së dosjes së kërkuar deri në mungesë totale të veprimeve procedurale për më shumë se 14 vjet në kundërshtim me detyrën e ngarkuar nga legjislacioni në fuqi. Gjykata konstaton se përmbarruesi gjyqësor publik ashtu, si dhe ai privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, por nuk i ka përdorur ato me efikasitet, duke u bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

32. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se afati nga momenti i procedurave të ekzekutimit deri në paraqitjen e kërkesës para Gjykatës është i gjatë dhe përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Veprimet e mësipërme të Zyrës së Përmbarrimit Tiranë nuk krijojnë bindjen te Gjykata se është treguar seriozitet nga ana e këtij subjekti për të zbatuar legjislacionin në fuqi për sa i takon zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

33. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete, si dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se mosveprimi i zyrës së përmbarrimit prej vitesh ka sjellë vazhdimin e cenimit të së drejtës së kërkuar për të gëzuar të drejtën e fituar në rrugë gjyqësore. Nga zyra e përmbarrimit Tiranë janë kryer fillimisht veprimet konkrete për ekzekutim, si p.sh.: kërkesa për vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e luajtshme të përbërë nga 35% e kapitalit Agitb, si dhe të ardhurat që sigurohen nga ky kapital. Po kështu në datën 30.11.2001, përmbarruesi i është drejtuar Zyrës së Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar fshirjen e shënimit të dhurimit të bërë për pjesën prej 35% të kapitalit nga ana e debitorit. Kjo kërkesë është përsëritur disa herë (në vitet 2001, 2003, 2004). Pas kësaj periudhe ka pasur një heshtje dhe mosveprim nga ana e zyrës së përmbarrimit, e cila në rrugë

verbale i është përgjigjur interesimit dhe kërkesave të kërkuar (shih kërkesat e datave 2.6.2006, 12.8.2009 etj.) se “dosja nuk gjendet”. Kërkesja i ka riparuar dokumentet dhe procesi është riaktivizuar sërish në datën 18.10.2015 dhe si pasojë janë nxjerrë këto akte: lajmërim për ekzekutim vullnetar, si dhe aktet drejtuar bankave të nivelit të dytë për sekuestro të llogarive të debitorëve. Kjo e fundit nuk është kryer pasi sipas Bankës Raiffeisen dokumentacioni nuk plotëson kriteret ligjore.

34. Gjykata konstaton se ndërkohë kërkuarja i është drejtuar edhe instancave administrative përkatëse për të vënë në lëvizje zyrën e përmbarrimit, e cila megjithëse rifilloi procesin e ekzekutimit të të dyja vendimeve gjyqësore, nuk arriti ta realizojë detyrimin për ekzekutim. Kështu, ajo i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, e cila nga ana e saj pasi ka marrë informacion për ecurinë e procesit në zyrën e përmbarrimit Tiranë, nuk ka dhënë ndonjë zgjidhje për situatën e krijuar nga zvarritja e procesit të ekzekutimit.

35. Gjykata vlerëson se zyra e përmbarrimit, përballë refuzimit të vazhdueshëm tejet të gjatë të debitorit për të zbatuar vendimin gjyqësor ndaj kreditorit, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e mjetit të përshtatshëm ligjor për të siguruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si tituj ekzekutiv. Gjykata sjell në vëmendje të subjektit të interesuar se legjislacioni në fuqi i përshtatur sipas zhvillimeve bashkëkohore për sa u takon autoriteteve të ngarkuara drejtpërdrejt me zbatimin e vendimeve gjyqësore ka parashikuar krahas përmbarruesit publik edhe përmbarruesin privat, me qëllim shtimin e mundësive në dispozicion të shtetasve për të realizuar efektivisht të drejtat e tyre të fituara në rrugë gjyqësore. Pavarësisht mënyrës së organizimit të tyre që mund të jetë e ndryshme, mjetet administrative dhe ligjore që shërbimi përmbarrimor ka në dispozicion janë të njëjta pavarësisht nëse është publik ose privat. Shërbimi përmbarrimor ka detyrimin të gjejë dhe të zbatojë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion me qëllim kryerjen e funksionit për të cilin ai është ngritur. Në këtë kontekst i takon Ministrisë së Drejtësisë që nëpërmjet strukturave të saj të monitorojë zbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi nga ana e shërbimit përmbarrimor publik ose privat dhe në rast të konstatimit të shkeljes nga ana e tij të marrë masat përkatëse. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor prej



më shumë se 14 vitesh duhet të kishte sjellë një reagim të Ministrisë së Drejtësisë, si institucion përgjegjës për sa i takon shërbimit përmbartimor. Vetëm kontrolli nëse janë përpiluar aktet procedurale pa u shoqëruar me veprime konkrete dhe të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm nga ana e zyrës së përmbartimit.

36. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosëkzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 338, datë 14.2.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. 1060, datë 2.10.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 67, datë 25.10.2016

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR DHËNIEN E NDIHMË DE MINIMIS

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|----------|
| - Znj. Milva Ekonomi | kryetar; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtar; |
| - Z. Ahmet Mançellari | anëtar; |
| - Z. Petrit Bakui | anëtar; |
| - Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |

Në mbështetje të nenit 8, 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De Minimis”,

VËREN SE:

1. Pika 1, e kreut IX, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De Minimis”, parashikon se:

“Dhënësi i ndihmës “De minimis” i kërkon ndërmarrjes një deklaratë mbi çdo ndihmë “de minimis” të përftuar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës nënshkruan deklaratën, sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.”

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ngarkohet të miratojë modelin e deklaratës që duhet nënshkruar nga përfituesi i ndihmës *de minimis*.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Miratimin e deklaratës për dhënien e ndihmës *De Minimis*, sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Milva Ekonomi**



DEKLARATË

NDIHMA SHTETËRORE *DE MINIMIS*

Unë, lindur më _____, me vendbanim _____, në cilësimë e përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjes/shoqërisë tregtare _____, me NIPT _____, me seli në _____,

në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*".

DEKLAROJ SE:

1. Ndërmarrja, që përfaqësoj:

- ☐ Nuk është e kontrolluar nga, apo nuk kontrollon, direkt ose indirekt, ndërmarrje të tjera;
☐ Kontrollon, qoftë edhe indirekt, ndërmarrjet e tjera me seli në territorin e Shqipërisë;

☐ Është e kontrolluar, qoftë dhe indirekt, nga ndërmarrje të tjera me seli në territorin e Shqipërisë;

2. Ndërmarrja, që përfaqësoj, gjatë këtij vit financiar apo dy viteve të mëparshme:

- ☐ Ka qenë objekt, bashkimi me ndërmarrje tjetër apo ndarje, në dy apo më shumë ndërmarrje;
☐ Nuk ka qenë objekt, bashkimi me ndërmarrje tjetër apo ndarje në dy apo më shumë ndërmarrje.

3. Deklaroj se ndërmarrja, që përfaqësoj:

- ☐ Nuk ka përfutur ndihmë *De Minimis*, bazuar në vendimin e KM-së nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*";
☐ Ka përfutur ndihmë *De Minimis*, bazuar në vendimin e KM-së nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*", si më poshtë:

Ndërmarrja përfutuese ¹	Baza ligjore	Data e dhënies së ndihmës	Dhënësi i ndihmës	Shuma bruto

Unë deklaroj se shuma e përgjithshme e ndihmës *De Minimis* përfutur nga ndërmarrja _____ gjatë tre viteve të njëpasnjëshme financiare është:

Viti 1 () ALL	Viti 2 () ALL	Viti 3 () ALL	Total ALL

Ndërmarrja
Emri
Pozicioni
Data
Nënshkrimi

¹ Në rast bashkimi apo ndarje të ndërmarrjeve duhet të tregohet ndërmarrja që ka përfutur ndihmë.



VENDIM

Nr. 68, datë 25.10.2016

**AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR PROJEKTIN
TË REJAT DREJT NJË PROFESIONI”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|----------|
| - Znj. Milva Ekonomi | kryetar; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtar; |
| - Z. Ahmet Mançellari | anëtar; |
| - Z. Petrit Bakiu | anëtar; |
| - Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 25.10.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim Planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për projektin të rejat drejt një profesioni”.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. prot. 27677, datë 14.9.2016, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ka njoftuar pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më poshtë “MZHETTS”), planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për projektin të rejat drejt një profesioni”.

II. Përshkrimi i masës

2. Objekti: Plani i ndihmës ka për qëllim të mbështes një grup punëkërkuesish të papunë, me qëllim lehtësimin e integritit në jetën shoqërore, ekonomike dhe në tregun e punës.

3. Projekti parashikon të mbështesë kategorinë e të rinjve nën moshën 24 vjeç, të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit, kanë më pak se 24 muaj që kanë mbaruar këto studime dhe janë të papunë.

4. Baza ligjore për dhënien e ndihmës, është:

a) Neni 24 i ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;

“Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. *Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të*

kufizuar, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. *Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

3. *Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.*

4. *Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

b) Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.1.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016”.

Buxheti Vjetor i Bashkisë Tiranë 2016

Programi 10140 “Kujdesi social dhe solidariteti”

5. *Dhënësi* i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Mbështetja për këtë program do të përballohet nga fondet e buxhetit 2016 të Bashkisë Tiranë.

7. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2018.

8. Përfituesit: Përfitues janë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë së Tiranës.

9. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

10. Vlera e ndihmës/ buxheti i planifikuar/ humbjet në buxhet: Fondi total i ndihmës në vitin 2016 është 3.600.000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

11. Ndërmarrjet fituese do të përfitojnë nga projekti një financim mujor në masën 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 6 (gjashtë) muaj.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

12. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikimeve dhe detyrimit që buron nga neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe



Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikë në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

13. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe
- c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.”

14. Sa më sipër:

Duke qenë se masa e njoftuar mundëson mbulimin e shpenzimeve të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, me fonde të buxhetit të pushtetit vendor, vetëm për një numër të caktuar ndërmarrjesh, që veprojnë në territorin e Bashkisë Tiranë. Bashkia Tiranë do t’u ofrojë këtyre ndërmarrjeve, si dhe, duke marrë parasysh, se masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson, se:

Neni 8, i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se:

“1. Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një

ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës de minimis.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”

Sa më sipër bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma de minimis lejohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa totali i shumës parashikuar për të financuar projektin është 3.600.000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë. Kjo shumë do të ndahet midis 11–50 ndërmarrjeve përfituese nga ndihma.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kriterëve të përcaktuara nga neni 8 Komisioni vlerëson se skema “Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor” është një skemë ndihme që lejohet.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për projektin të rejtat drejt një profesioni”.

2. Çdo ndryshim lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret e ndihmës duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Bashkia e Tiranës të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 4695/4, datë 2.11.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN NR. 4695, DATË
31.5.2016, “PËR PROCEDURAT E
HOLLËSISHME TË REGJISTRIMIT
DHE LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SË
PASURISË SË PALUAJTSHME TË
LEGALIZUAR”**

Në mbështetje të neneve 17 dhe 49, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neneve 4, 29 dhe 30, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 13, të VKM-së nr. 1095, datë 28.12.2015, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, kryeregjistruesi dhe drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 4695, datë 31.5.2016, “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. Regjistruesi vijon me regjistrimin e lejes së legalizimit për ndërtimin e ngritur mbi truallin e një objekti që rezulton i shembur, mjafton që subjekti të depozitojë pranë ALUIZNI-t deklaratën noteriale të prishjes së objektit. Ky dokumentacion përcillet pranë ZVRPP-së së bashku me atë të përcaktuar në pikën 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 28.12.2015”.

2. Në pikën 26, germa “b”, riformulohet si më poshtë:

“b) Kur marrëdhënia e pronësisë me truallin nuk është rregulluar ende, ZVRPP-ja zbaton rregullin e përcaktuar në pikën 13 të këtij udhëzimi dhe detyrohet të kryejë regjistrimin e pronësisë mbi parcelën ndërtimore, menjëherë pas miratimit të VKM-së “Për kompensimin e pronarëve”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEREGJISTRUESI
Ilirjan Muho

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Lame

VENDIM

Nr. 174, datë 7.11.2016

**MBI MIRATIMIN E
KONTRATËS/MARRËVESHJES PËR
SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA
DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË
TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE
TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN
E HUMBJEVE NË RRJETIN E
SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN
KOHORE 1.7.2016–31.12.2016**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 5, pika 4, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për



vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 23.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 7.11.2016, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për miratimin e kontratës/marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 26, datë 9.3.2016, ERE ka vendosur shtyrjen e afatit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, deri më 30.6.2016.

- Me vendimin nr. 145, datë 25.8.2016, Bordi i ERE-s ka filluar procedurat për miratimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016”.

- ERE, me shkresën nr. 643 prot., datë 30.8.2016, dërgoi draftkontratën/marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e

humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016”, për marrje mendimi të palët e interesit.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se ka paraqitur në ERE opinion mbi këtë marrëveshje vetëm Autoriteti i Konkurrencës duke vendosur të përjashtojë nga ndalimi kontratën/marrëveshjen.

- Në datën 18.10.2016, ERE organizoi një seancë dëgjimore për të diskutuar me palët në kontratë/marrëveshje përfaqësues të OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., përmbajtjen e dakordësuar të saj.

- OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., me shkresën nr. 24330 prot., i OSHEE sh.a. dhe nr. 8613/1 prot., i KESH sh.a., datë 24.10.2016 kanë dërguar në ERE kontratën/marrëveshjen e shitblerjes për tepricat e energjisë elektrike, të nënshkruar nga të dyja palët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën/marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016 (bashkëlidhur kontrata/marrëveshja me nr. 24330 prot. i OSHEE sh.a. dhe nr. 8613/1 prot., i KESH sh.a., datë 24.10.2016).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Nr. 8613 prot, datë 24/10/ 2016

Nr. 24330 prot, datë 24/10/ 2016

Marrëveshje për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.07.2016-31.12.2016

E lidhur sot me datë 24.10 2016, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga Z. Agron HETOJA, Administrator i KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "Shitësi",

dhe

OSHEE sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfaqësuar nga Z. Adrian ÇELA, Administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., që më poshtë quhet "Blerësi",

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si "Palët" dhe me vete si "Pala")

Baza ligjore: Ligji Nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Vendimi Nr.244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike",

- Në kushtet kur për vitin 2015 dhe për periudhën kohore 01.01.2016-30.06.2016, ka patur marrëdhënie kontraktore me shoqërinë OSHEE sh.a. për shitjen e nga ana e KESH sh.a., të sasive të tepërta të energjisë elektrike ose në rast prurjesh të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në Aktet nënligjore në fuqi, Rregullat e Shitjes të miratuara nga Bordi i ERE, Rregulloren e Shkarkimit të Plotave dhe atë të Sigurisë së Digave, përtej nevojave të klientëve tariforë, nëpërmjet dy kontratave për këtë qëllim, të miratuara përkatësisht me Vendimet nr.12, datë 06.02.2015, dhe nr.26, datë 09.03.2016, të Bordit të ERE-s,
- Në kushtet kur pika 4, e nenit 5, e Vendimit nr.244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", përcakton se (citojmë shprehimisht) "Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të Bursës Hungareze, HUPX, për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë, për produktin/profillin në bandë, siç publikohet në website-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE";

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet "Shitësi" dhe OSHEE sh.a. (në funksionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) që më poshtë do të quhet "Blerësi", lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt shit-bletjen e energjisë elektrike pas përmbushjes së sasise kontraktuale me FSHU për furnizimin e klienteve fundore, në kushtet e tepricës dhe prurjeve të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në aktet nënligjore në fuqi, Rregullat e Shitjes dhe Rregulloren e Shkarkimit të Plotave si dhe atë të Sigurisë së Digave, për mbulimin e pjesshëm ose të plotë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 01.07.2016- 31.12.2016.



Neni 2 Detyrimet Kryesore të Palëve

1. OSHEE sh.a., përpara çeljes së procedurës për blerjen në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a. përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike që kjo e fundit mund të shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.

KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha apo dhe tepërcave, pasi ka garantuar permbushjen e detyrimit kontraktual për FSHU për furnizimin e klienteve fundore, do të komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a. mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energji elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

2. Nëse të dyja palët bien dakord për shitjen/lëvrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, lëvrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

Neni 3 Çmimi

Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar të bursës hungarez HUPX për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë elektrike për produktin/profilin band, sic publikohet në website-in e kësaj burse.

Neni 4 Faturimi dhe Pagesa

1. Shitësi do t'i lëshojë Blerësit brenda datë 10, të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike një faturë ku të pasqyrohet sasia dhe vlera totale e energjisë elektrike të lëvruar gjatë periudhës përkatëse të lëvrimin.
2. Pagesa e faturës nga ana e blerësit, do të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është Dite Pune, ditën tjetër të punës.
3. Interesi i Mospagesës: Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga Data e Detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përjashtuar datën e pagesës me Përqindje Interesi. Për këtë qëllim: Kamatevonesa për pagese të vonuar: norma e interesit që do të aplikohet për çdo ditë vonese të pagesës të jetë masa e Yield – it mesatar të Bonove të Thesarit me maturim 1 vjeçar të publikuar nga Banka e Shqipërisë + 3% në vit, të llogaritur nga data e përcaktuar në pikën 2 të nenit 14 të kontratës deri në datën e pagesës së shumës së pa paguar të faturës. Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga Data e Detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përjashtuar datën e pagesës me Përqindje Interesi.

Neni 5 Mos-Performanca Për Shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësisht të kërkesës për klientët tariforë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontrates do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkak të e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - b. pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
 - c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes.
 - d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.
2. KESH sh.a. nuk do të shesë/levroje energji elektrike për OSHEE sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e sasisë kontraktuale me FSHU për furnizimin e klienteve fundore.
3. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e



Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.

4. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcë Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.
6. Në rast të mos livrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslivruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palëvruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.
7. Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.

Neni 6

Legjislacioni në Fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontraten do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi dhe i shtrijnë efektet pas miratimit nga ERE.
2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 8

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (kater) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

kesh
Energji e pastër që nuk shpërndahet
KONTRATË ELETROENERGJETIKE
SHËNIMET

Agron HETOTA
ADMINISTRATORI



Proloki
Adrian ÇELA
ADMINISTRATORI

**VENDIM****Nr. 175, datë 7.11.2016****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C
INERTE LUMZI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“TUC” DHE “LUMZI”**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; gjithashtu, dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Tuc” dhe “Lumzi”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.4, gjerat “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë, me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, germa “d”);

Faqe| 22910

- Të dhënat teknike për HEC-et (neni 9, pika 4.1.1);

- Studimi i fizibilitetit (neni 9, pika 4.1.4, germa “a”);

- Pika e lidhjes dhe lejet nga institucionet e tjera (neni 9 pika 4.1.5 gjerat “a”, “b”, “c”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tuc”, me fuqi të instaluar 4470 MW; Hec “Lumzi”, me fuqi të instaluar 11000 MW dhe fuqi totale 15470 MW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 176, datë 7.11.2016****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C
INERTE LUMZI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen



e tij të datës 7.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut; konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë, me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, gjerat “d”);

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 177, datë 8.11.2016

MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE, TË PROPOZUARA NGA SHOQËRIA “OSHEE” SHA, NË RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166, TË BORDIT TË ERE-s, DATË 10.10.2016

Në mbështetje të neneve 16; 20, gjerat “a”; 27, pika 3; 108, pika 3; 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26, të rregullores “Mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të ERE-s; nenit 6.2, të rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.11.2016, pasi shqyrtoi relacionin për miratimin e disa shitesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria “OSHEE” sh.a., në rregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të përgatitur nga drejtoritë teknike;

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”.

2. Me shkresën me nr. 795/1 prot., datë 1.11.2016, është bërë një kërkesë nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a., për ndryshime në rregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të miratuar me vendimin nr. 166, të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016.

3. Me shkresën me nr. 795/1 prot., datë 1.11.2016, shoqëria “OSHEE” sh.a., sqaron se:

OSHEE-ja është në fillimet e para të zbatimit të projektit të Datacleaning në BS/OSHEE.

- Projekti GIS për rrjetet shpërndarëse të energjisë elektrike, është:

- Në masën rreth 80% të implementimit për nivelet e tensionit TL dhe TM.

- Akoma nuk ka filluar zbatimin e projektit GIS në nivel konsumatori fundor.

- Sa ka nisur procesin e projektit të “Adresarit të popullatës” për popullimin e plotë të të dhënave në territor;

- Pasaktësitë e koordinatave në terren, të cilat mund të atakojnë shtresat e ndryshme me probleme sociale dhe ekonomike;



- Impakti që krijohet në shtresat e familjeve në nevojë;

- Impakti për biznesin e vogël, i cili zë peshën dërrmuese të kërkesave për lidhje të reja;

- Synohet eliminimi i çdo elementi diskriminues në aplikimin e tarifave.

4. Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 24974/1 prot., datë 4.11.2016, ka paraqitur një relacion me analizën tekniko-ekonomike përkatëse lidhur me tarifat T1 dhe T4.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016, me përmbajtjen si më poshtë:

1.1 Pika 1, e germës “e”, të nenit 3.6, të rregullores, ndryshon si më poshtë:

“Kabina TIP 1: muraturë për furnizim të godinave të banimit dhe shërbimit (një ambient). Ky tip kabine do të projektohet që të ndërtohet në kufirin e pronësisë të aplikantit me dyer të aksesueshme nga jashtë godinës, në afërsi të rrugës. Kjo kabinë do të ketë një ambient në të cilën do të vendosen të gjitha pajisjet e kabinës”.

1.2 Në germën “c”, të nenit 4.4, të rregullores, shtohen 2 tabelat e mëposhtme dhe teksti vijues:

TABELA E TARIFËS T2 SIPAS DISTANCËS PËR LIDHJE NË TU

Tarifa e distancës në TU		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m
a	Brenda 200 m	2000	-
b	Për çdo 100 m të shtuar		1000

TABELA E TARIFËS T2 SIPAS DISTANCËS PËR LIDHJE NË TM

Tarifa e distancës në TM		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 1 km
a	Brenda 1 km	4500	-
b	Për çdo 1km të shtuar		4500

Tarifa T4 - tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes do të përbëhet nga këta komponentë:

1. Tarifë për azhurnimin e rrjetit
2. Tarifë për shpenzime administrative

3. Tarifa e verifikimit/kolauditimit fillestar të matësit monofazë dhe trefazorë, referuar parashikimeve të nenit 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

1.3 Neni 4.6 i rregullores, ndryshon si më poshtë:

Tarifat për lidhje në tension të ulët

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të ulët 0.4 kV

a) Konsumatorë familjarë

T1 = 1000 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

b) Konsumatorët jofamiljarë

T1 = 5000 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2.500 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

1.4 Neni 4.7 i rregullores ndryshon si më poshtë:

1. Neni 4.7 i rregullores së miratuar me vendimin nr. 166, të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016, bëhet neni 4.7, germa “a” e rregullores dhe ndryshon si më poshtë:

T1 = 23000 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 1700 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

2. Shtohet germa “b” e nenit 4.7 me përmbajtje si vijon: “Për konsumatorët në godina banimi dhe shërbimi, në tarifën T4 nuk do të përfshihet tarifa për azhurnimin e rrjetit”

1.5 Neni 4.8 i rregullores ndryshon si më poshtë:

Tarifat për lidhje në tension të mesëm 35 kV

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 35 kV

T1 = 23000 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2,000 lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

1.6 Neni 4.9, germa “a” e rregullores, ndryshon si më poshtë:

Konsumatorë familjarë

T1 = 0 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave



$T3 = 2,000 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)

$T4 =$ Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

1.7 Neni 4.9, germa “b” e rregullores, ndryshon si më poshtë:

Konsumatorë jofamiljarë në tension të ulët

$T1 = 0 \text{ lekë}$

$T2 =$ sipas tabelës së distancave

$T3 = 2500 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)

$T4 =$ Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

1.8 Neni 4.9, germa “c” e rregullores, ndryshon si më poshtë:

Konsumatorë jofamiljarë në tension të mesëm

$T1 = 0 \text{ lekë}$

$T2 =$ sipas tabelës së distancave

$T3 = 1700 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)

$T4 =$ Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

1.9 Neni 4.9, germa “d” e rregullores, ndryshon si më poshtë:

Konsumatorë jofamiljarë në tension të mesëm 35 kV

$T1 = 0 \text{ lekë}$

$T2 =$ sipas tabelës së distancave

$T3 = 1700 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar)

$T4 =$ Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

2. Shtesat dhe ndryshimet e pikës 1 të këtij vendimi, reflektohen gjithashtu në aneksin “Tarifat për lidhjet e reja”, bashkëlidhur rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, të Bordit të ERE-s, datë 10.10.2016 (bashkëlidhur vendimit, aneksi i ndryshuar “Tarifat për lidhjet e reja”).

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ANEKSI 2

TARIFAT PËR LIDHJET E REJA

T1 – TARIFA E STUDIMIT DHE VLERËSIMIT E MIRATIMIT TË PROJEKTIMIT

T1 është tarifë fikse, lidhur me kostot për studimin e projektit të lidhjes së re dhe studimit dhe azhurnimit të pikës së lidhjes me metodologjinë GIS. Sipas kategorizimit të klientëve dhe nivelit të tensionit ku kërkohet lidhja e re, është përcaktuar:

1. Për klientët familjarë – $T1 = 1000 \text{ lekë}$;
2. Për klientët jofamiljarë në tension të ulët – $T1 = 5000 \text{ lekë}$;
3. Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20/35 kV – $T1 = 23000 \text{ lekë}$;
4. Për shtesë fuqie, modifikim lidhje, transferim lidhje – $T1 = 0 \text{ lekë}$.

T2 – TARIFA E DISTANCËS

- Tarifa e distancës për lidhje të klientëve në TU ka të bëjë me largësinë e klientit nga kabina më e afërt e transformimit.

Tarifa e distancës në TU		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m
a	Brenda 200 m	2000	-
b	Për çdo 100 m të shtuar		1000

- Tarifa e distancës për lidhje të klientëve në TM ka të bëjë me largësinë e kabinës së transformimit nga nënstacioni më i afërt.

Tarifa e distancës në TM		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 1 km
a	Brenda 1 km	4500	-
b	Për çdo 1km të shtuar		4500

T3 – TARIFA E FUQISË (lekë/kW, kundrejt fuqisë së kërkuar)

1. Tarifa T3, bazuar në kategorizimin e klientëve dhe nivelit të tensionit ku kërkohet lidhja e re, është përcaktuar:

$T3 = 1.700 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë së kërkuar) për aplikim në TM 6/10/20 kV

$T3 = 2.000 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë së kërkuar) për aplikim në TM 35 kV

$T3 = 2.500 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë së kërkuar) për aplikim në TU (privat)

$T3 = 2.000 \text{ lekë/kW}$ (kundrejt fuqisë së kërkuar) për aplikim në TU (familjarë)



2. Për shtesa fuqie, modifikim lidhje, transferim lidhje, tarifa T3 bazuar në kategorizimin e klientëve dhe nivelit të tensionit ku kërkohet lidhja e re, është përcaktuar:

T3 = 1.700 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar) për aplikim në TM 6/10/20 kV (privat);

T3 = 1.700 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar) për aplikim në TM 35 kV (privat);

T3 = 2.500 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar) për aplikim në TU (privat);

T3 = 2.000 lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë së kërkuar) për aplikim në TU (familjarë).

T4 – TARIFA E SHËRBIMEVE PËR REALIZIMIN E LIDHJES SË RE DHE KOLAUDIMIT FILLESTAR TË MATËSIT

Tarifa T4 është tarifë fikse e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe verifikimit/kolaudimit fillestar të matësit. Kjo tarifë përbëhet nga këta komponentë:

1. Tarifë për azhurnimin e rrjetit1500 lekë

2. Shpenzime administrative1000 lekë

3. Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësve:

- monofazë

- trefazor

Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësit, i referohet parashikimeve të nenit 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2016-4389 (1116), datë 17.10.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Shpëtim Jaup Dauti, duke caktuar si ditë të zhdukjes së tij datën 1.10.1991, si dhe caktoi shtetasin Dashamir Jaup Dauti si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasja Rukie Salia banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur që nga viti 1997 të shtetasit Xhavit Salia, i datëlindjes 4.4.1951.

KËRKUESE

Rukie Salia

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë